



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

viti shkollor 2011/2012

TESTI

MATEMATIKË

UDHËZIM PËR PUNË NË TEST

Testi të cilin duhet ta plotësosh i ka 20 detyra. Për zgjidhjen e këtij testi janë parashikuar 120 minuta. Secilën detyrë së pari lexoje me kujdes mendo për këtë se çfarë kërkohet në të. Së pari zgjidhi ato detyra të cilat janë më të lehta për ty, e më vonë zgjidhi ato detyra të cilat për ty janë të vështira.

Lexoje me kujdes tekstin e secilës detyre sepse në të është shpjeguar në çfarë mënyre duhet të përgjigjesh. Në detyra prej teje kërkohet të rrethosh shkronjën para përgjigjes së saktë, t'i bashkosh pjesët e përgjigjesh, të shkruash diçka etj.

Ki kujdes për mënyrën se si duhet të përgjigjesh. Gjatë punës mund të përdorësh gomën, vizoren, trekëndëshin dhe kompasin. Nuk guxon ta përdorësh telefonin/celularin dhe kalkulatorin (digitronin).

Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shëno asgjë, ajo është hapësirë në të cilën shënohet numri i pikave.


Në këtë dhe në faqen e fundit mos shkruaj asgjë.

Testin duhet ta plotësosh me **stilolaps**. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin grafit dhe gomën. Detyrat zgjidhi së pari me laps grafit sepse kështu ke mundësi që, nëse e vëren gabimin, këtë gabim ta korrigjosh.

Para se që e dorëzon testin, verifiko përgjigjet tuaja edhe njëherë, e pastaj të gjitha përgjigjet shkruaj me stilolaps. Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps grafit nuk do të pranohet, por as përgjigjja të cilës i është hequr vizë.

Nëse e mbaron testin më herët, dorëzoja testin arsimtarit kujdestar dhe dil ngadalë që të mos i pengosh shokët.

Të dëshirojmë sukses në provim!



1. Cili nga numrat e ofruar është i barabartë me numrin 0,3?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

a) $\frac{10}{3}$

b) $\frac{3}{10}$

c) $\frac{1}{3}$

d) $\frac{3}{1}$

2. Endriti ka zgjidhur katër detyra. Tri detyra i ka zgjidhur saktë kurse në njëren detyrë ka bërë gabim në llogaritje.

Rretho shkronjën para detyrës të cilën Endriti nuk e ka zgjidhë saktë.

a) $\frac{1}{4} + \frac{1}{4} = \frac{1}{2}$

b) $\frac{1}{4} - \frac{3}{4} = -\frac{1}{2}$

c) $\frac{1}{4} : \frac{5}{4} = \frac{1}{5}$

d) $\frac{1}{4} \cdot \frac{5}{4} = \frac{5}{8}$

3. Rrumbullakso shifrën në vend të shenjës ♣ ashtu që gjashtshifrori 545♣328 të mund të plotpjestohet me 3.

0

1

2

3

4

5

6

7

8

9

4. Llogarit vlerën e shprehjes.

Trego procedurën.

$$\left(\frac{1}{3} - \left(\frac{1}{5} + \frac{2}{3}\right)\right) : \left(\left(\frac{1}{15} + \frac{3}{5}\right) : \frac{3}{2}\right) + \frac{1}{5}$$



Zgjidhje: _____

5. Cili numër është zgjidhje e barazimit $\frac{x}{3} + 3 = 6$?

Trego procedurën.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

a) 9

b) 27

c) 1

d) -3



6. Lidhni çdo shprehje me vlerat që i përgjigjen.

$$2^4 + 4^2 \bullet$$

$$2^3 - 3^2 \bullet$$

$$6^2 \cdot 2^2 \bullet$$

$$8^2 : 2^3 \bullet$$

• 8

• 144

• -1

• 0

• 32

7. Nga nje litër sirup të limonit fitohet 8 litra sok. Sa litra sok fitohet nga 0,75 l të atij sirupi?
Trego procedurën.



Fitohet _____ l sok.

8. Diferenca e dy numrave është 6. Kur gjysma e shumës së atyre dy numrave rritet për 5 atëher fitohet numri 19. Cilat janë ata numra?

Trego procedurën.

Ata numra janë _____ dhe _____.

- 9.** Pllaka (pllaka nxehtë) në shporetin elektrik ka formë të rrumbullakët me rreze 6 cm. Sa është sipërfaqja e pllakës?


Trego procedurën.

Sipërfaqja e plakës është _____ cm^2 .



- 10.** Tehu i bazës së prizmit të rregullt katërfaqësh është 6 cm, kurse lartësia e prizmit është 10 cm. Sa është sipërfaqja e prizmit të dhënë?

Trego procedurën.



Sipërfaqja e prizmit është _____ cm^2 .



- 11.** Madhësija e njërit kënd të jashtëm të trekëndëshit është 132° , ndërsa madhësija e njërit kënd të mbrendëshëm është 62° . Llogarit madhësin e atyre dy këndeve të mbrendëshëm të atij trekëndëshit.
Trego procedurën.

Madhësitë e atyre dy këndeve janë _____ dhe _____.



- 12.** Brinja e bazës së prizmit të rregullt gjashtfaqësorë është 5 cm, ndërsa diagonalja e faqes ansore të atij prizmi është 13 cm. Llogarit sipërfaqën dhe vëllimin e atij prizmi.
Trego procedurën.

$$S = \text{_____ cm}^2$$

$$V = \text{_____ cm}^3$$



13. Mrika ka thënë: „Sipërfaqja e dhomës sime është 12 m².“

Tulanti ka thënë: „Distanca prej shtëpie deri në shkollë është 1,5 km.“

Era ka thënë: „Vëllimi i paketës së parfimit është 100 ml.“

Teuta ka thënë: „Sasia e një akullore është 200 cm³.“

Vjollca ka thënë: „Nëna ime çdo ditë punë kalon 8 orë në punë.“

Kush e ka përdor gabimisht njësinë matëse?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

a) Mrika

b) Taulanti

c) Era

d) Teuta

e) Vjollca

14. Mentori i ka 7 bankënota prej nga 50 dinarë dhe 6 bankënota prej nga 20 dinarë. Ai dëshiron të paguajë mbushjen për celular prej 600 dinarësh për të fituar bonusin. Edhe sa të holla duhet të kursejë për të blerë mbushjen?

Mentori duhet të kursejë _____dinarë.

15. Numrin 7124,8276 rrumbullakso në


a) numrin më të afërt të plotë _____

b) një decimale _____

c) qindshen më të afërt _____

- 16.** Petriti dhe daja i vet në 25 ari tokë kanë mbjellur patate. Më vonë ato patate i kanë shitur në treg me çmim 50 din. për kilogram. Sa ata kanë fituar, nëse mesatarja e papateve për një hektar është 10 tonë?

Trego procedurën.



Ata kanë fituar _____ din.

- 17.** Nga 20 detyra në test Majlinda saktësisht i ka zgjidhur 75% detyra. Sa detyra i ka zgjidhur saktësisht Majlinda?

Trego procedurën.

Majlinda saktësisht i ka zgjidhur _____ detyra.

18. Në tabelë janë paraqitur numri i të rrahurave të zemrës në minut tek disa kafshë.

Kafshët	Numri i të rrahurave të zemrës në minute
qeni	100–130
maca	100–140
lopa	62–73
kali	31–51
lepuri	200–220
zogu	350–450
majmuni	170–200
derri	55–86

Më shumë se 300 të rrahura të zemrës në minut ka _____.

Më së paku se 52 të rrahura të zemrës në minut ka _____.



19. Llogarit mesin aritmetik të numrave: 20, 17, 34, 11 dhe 45.

Trego procedurën.

Mesi aritmetik është _____.



20. Në internet adresën www.google.com/adplanner/static/top1000 janë dhënë të dhënat e frekuentimit të ndonjërit vebsajtit të periudhës së kaluar.

Rangu	Vebsajt	Kategoria	Numri i frekuentuesve (shfrytzuesit)	% e shfrytzuesve të internetit që e frekuentojnë vebsajtin	Numri i shiqeshmërisë së faqes
1.	facebook.com	Rrjeti social	880 000 000	47,2%	910 000 000 000
2.	youtube.com	Video onlajn	800 000 000	42,7%	100 000 000 000
3.	yahoo.com	Veb portali	660 000 000	35,3%	77 000 000 000
4.	live.com	Kërkushmëria	560 000 000	29,3%	36 000 000 000
5.	wikipedia.org	Fjalori dhe enciklopedia	490 000 000	26,2%	7 000 000 000
6.	msn.com	Veb portali	450 000 000	24%	15 000 000 000
7.	blogspot.com	Servisimi dhe blogovimi	410 000 000	21,9%	5 400 000 000
8.	baidu.com	Kërkushmëria	340 000 000	18%	110 000 000 000
9.	bing.com	Kërkushmëria	340 000 000	18,3%	11 000 000 000
10.	microsoft.com	Softver	340 000 000	18,3%	2 700 000 000
11.	qq.com	Veb portali	280 000 000	15%	44 000 000 000
12.	ask.com	Kërkushmëria	210 000 000	11,2%	2 000 000 000
13.	taobao.com	Reklama	190 000 000	10,3%	30 000 000 000
14.	adobe.com	Softveri multimediatik	170 000 000	9,2%	1 000 000 000

Duke shfrytzuar tabelën e dhënë plotsoni fjalitë e dhëna.

Në kategorin e kërkushmërisë, dallimin në mes të frekuentimit më të madhë dhe më të vogël të vebsajtit sipas numrit të frekuentuesve është _____.



Rezultati në testin e matematikë

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!
Këtë faqe e plotëson Komisioni!

Numri i përgjithshëm i pikave

		,	
--	--	---	--

Komisioni:

- _____
- _____
- _____
- _____

Numri i pikave për secilën detyrë.

Numri i detyrës	E paplotësuar	0 pika	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shkruaj ✕ në vendin përkatës.

Numri i identifikimit (Shifra e nxënësit)	
Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	